

Afate

Afatet për pranimin e mallrave dhe dokumenteve për dorëzim në Aeroportin ndërkombëtar Shkup

Të dhënat më poshtë vlejné për kargo të lehta të transportuara me avione pasagjerësh, avione kargo dhe kamionë (RFS ose CMR):

		<i>Koha e dorëzimit para nisjes</i>
Pranim i kargos/mallit	Kargo e përgjithshme që mund të transportohet	Deri më 180 min.
Dorëzim i kargo manifestit	Bëjmë rezervim/regjistrim të kargos me dokumentacion të plotë në varësi të kapacitetit të disponueshëm të itinerarit	120 min.
ANNEX dorëzim	Deri në 1 ton kargo dhe kargo manifest në 2 fleta ngarkese (AWBs)	90 min.
LMS dorëzim i kargo manifestit	Vetëm lloje të caktuara të mallrave: VAL, PERI, AVI, LHO, PRESS (deri në 200 kg mallra dhe 2 AWB) dhe postë deri në 200 kg	90 min.

Për sasi më të mëdha të mallrave për transport në një avion pasagjerësh ose avion kargo, është e nevojshme të bëni një rezervim/kontratë paraprake me agjencinë e transportit, pasi informacioni i dhënë këtu nuk zbatohet për raste të tilla.

Dërgimi i dërgesave

Procedurat për përgatitjen e mallrave për dërgim

Mënyra se si udhëton kargoja juaj dhe kushtet në të cilat ajo arrin në destinacionin e saj varen kryesisht nga dërguesi. I gjithë procesi i përgatitjes së kargos për dërgesë fillon pasi të merret porosia. Vendimi juaj për llojin e transportit bazohet në kërkesat e marrësit për sa i përket sasisë, urgjencës dhe kostos së transportit. Më tej, duhet të siguroheni që mallrat janë pakëtuar dhe shënuar siç duhet.

Kur mallrat janë të përgatitura për dorëzim/dërgim, duhet të kontaktoni kompaninë e transportit të mallrave dhe të rezervoni hapësirën e transportit për tërë udhëtimin e kargos. Kompania e transportit do të kërkojë informacion të detajuar në lidhje me mallrat që po dërgoni. Pas konfirmimit të rezervimit, duhet të përgatitni të gjitha dokumentet e nevojshme për dorëzim. Kjo përfshin disponimin e eksportit, faturën, formën e lëshimit, licencën e eksportit (nëse kërkohet) dhe deklaratën e dërguesit për lloje të veçanta të mallrave. Deklarata përfshin informacionin për dërguesin, marrësin, numrin e fletës së dërgesës AWB, aeroportin nga i cili është dërguar kargoja dhe aeroportin ku do të mbërrijë kargoja, mallrat, mënyrën e pagesës, kushtet e pagesës, kohën e dorëzimit, sigurimit dhe doganimit. Nëse kompania e transportit nuk e bën këtë për ju, do të duhet vetë të dorëzoni kargon në aeroport.

Pasi dërgesa të jetë dërguar, rekomandohet që të gjitha informacionet e dërgesës t'i dërgohen marrësit në mënyrë që të mund të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për marrjen përpara se dërgesa të mbërrijë në destinacionin përfundimtar. Mbani në mend se dorëzimi i mallrave është një çështje komplekse. Ne ju rekomandojmë që të konsultoheni me një kompani transporti

mallrash përpara se të dorëzoni ndonjë kargo, për të marrë informacion mbi kushtet e veçanta dhe kërkesat ose përfitimet e ofruara nga linjat ajrore.

Pranimi i dërgesave (import)

- Pas njoftimit të marrjes së dërgesës, blini AWB-në ose kontaktoni agjencinë e transportit të mallrave për të filluar procedurat doganore.
- Pastaj, përbushni të gjitha procedurat doganore. Për të dy shërbimet, ju mund të autorizoni njërin nga kompanitë e transportit të mallrave që operon në Aeroportin Ndërkombëtar Shkup.
- Pas pagimit të tarifës së magazinimit, dërgesa do të dorëzohet tek automjeti i juaj përpara magazinës.
- Pranimi i mallit të lëshuar konfirmohet duke nënshkruar urdhrin e dërgesës.

Vërejtje:

Nëse brenda 20 ditëve (mallrat e prishshme - 3 ditë) nuk fillohet procedura doganore, autoritetet doganore do të shkatërrojnë dërgesën dhe të gjitha kostot që lidhen me të do të përballohen nga transportuesi/dërguesi, përveç nëse parashikohet ndryshe.

Llojet e veçanta të mallrave

Lloje të veçanta të mallrave konsiderohen dërgesat që kërkojnë pritje, ruajtje, ngarkim dhe transport të veçantë për shkak të **natyrës së tyre** (materiale të rrezikshme, kafshë të gjalla, mallra që prishen, kufoma, etj.), **vlërës** (dërgesat me vlerë, dërgesat me vlerë të lartë), **dimensionet dhe peshës** (të madha/të rënda), **ose rregulloret kombëtare** (armë, municion, etj.).

Procedurat e veçanta zbatohen për të mbrojtur:

Transportuesit

Personat që merren me mallrat

Dërgesat e tjera

Vetë dërgesën.

Kargo qendra e Aeroportit Ndërkombëtar Shkup ofron marrjen, ruajtjen dhe dërgimin e të gjitha llojeve të mallrave në përputhje me rregulloret në fuqi të rregullave të IATA dhe TAST. Kushtet dhe kërkesat e veçanta zbatohen për paketimin, shënimin/afishimin dhe ruajtjen e artikujve të tillë, kështu që ju këshillojmë që para se të dërgoni mallra të tilla, të kontaktoni dhe konsultoheni me Kargo qendrën në numrat vijuse të telefonit: +389 2 3148 636, +389 2 3148 627, e-mail: dino.nikolovski@tav.aero ose kontaktoni dhe këshillohuni me kompaninë tuaj të transportit.